URDHËR
Nr. 153, date 30.7.2020

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të pikës 1, të nenit 12, dhe të pikës "b", të nenit 13, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; si edhe të germës "c", pika 2, të nenit 7, të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit;,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari, si vijon:

- Përfaqëson Kolegjin në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë, por jo kufizuar këto marrëdhënie në bashkëpunime me institucionet e tjera, organet publike, organizata ndërkombëtare.

2. Delegimi i kompetencës së mësipërme është për periudhën nga data 5.8.2020 deri në datën 15.8.2020.

3. Gjyqtari z. Ardian Hajdari, për periudhën e sipërcituar, do të nënshkruajë në emër të kryetarit në mungesë të tij:

- Shkresat që dalin nga institucioni drejtuar Komisionerit Publik, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si edhe denoncuesve, lidhur me denoncimet e paraqitura prej tyre pranë Kolegjit, të cilat janë brenda afatit të ankimimit.

4. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari.

5. Gjyqtari z. Ardian Hajdari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla